

[Printo]

[Google Translate]

LIGJ

Nr.10 345, datë 4.11.2010

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR. 8093, DATË 21.3.1996 "PËR REZERVAT UJORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 61 paragrafi i dytë shkronja "a", shifra "500 000 (pesëqind mijë) lekë" zëvendësohet me shifrën "2 000 000 (dy milionë) lekë".

Neni 2

Pas nenit 71 shtohet neni 71/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 71/1

Këshilli i Ministrave miraton formularin përkatës, ku dokumentohen procedurat e zbatuara nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, sipas përcaktimeve të shkronjës "c" të nenit 61 të këtij UgL".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.6769, datë 15.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Copyright 2012 - www.ligjet.org